



**Law Journal**

**REFORMA NË DREJTËSI | SHKURT 2018**

**ECURIA E KRIJIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË  
PROKURORISË  
(K.L.P)**

## ECURIA E KRIJIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË (K.L.P)

### I. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi që, sipas nenit 149 të Kushtetutës së Ndryshuar, do të garantojë pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Neni 149/a i Kushtetutës së ndryshuar, cakton funksionet e rëndësishme që KLP-ja do të ushtrojë mbi Prokurorët shqiptarë:

- i. Emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;
- ii. Vendosjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- iii. Propozimin e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm;
- iv. Miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të etikës së prokurorëve;

KLP-ja është një organ kolegjal i cili përbëhet nga 11 anëtarë. Përkatësia profesionale dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të KLP-së është e ndryshme.

Shumica e thjeshtë e anëtarëve të KLP-së (**6 anëtarë**) zgjidhet nga radhët e Prokurorëve të të gjitha niveleve: (i) 3 prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë ; (ii) 2 prokurorë pranë gjykatave të Apelit, përfshirë Prokurorinë e Posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar; (iii) 1 Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Anëtarët nga radhët e Prokurorisë zgjidhen nga **Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve** sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Ligji Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” (Ligji 115/2016). Pakica e anëtarëve të KLP-së (**5 anëtarë**) zgjidhen nga radhët e juristëve jashtë prokurorisë: (i) 2 anëtarë nga radhët e avokatëve; (ii) 2 anëtarë nga pedagogët e fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës; (iii) 1 anëtar nga shoqëria civile. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë janë të përcaktuara në nenin 149 të Kushtetutës së ndryshuar dhe Ligjin 115/2016. Miratimin përfundimtar të anëtarëve të KLP-së nga radhët e juristëve jashtë Prokurorisë e kryen **Parlamenti i Republikës së Shqipërisë**.

Për shkak të rëndësisë së këtij organi për funksionimin e reformës në drejtësi, Neni 179 i Kushtetutës së ndryshuar dhe Ligji 115/2016 kanë përcaktuar që KLP-ja duhet të krijohet **jo më vonë se 8 muaj** pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese<sup>1</sup>. Ndryshimet Kushtetuese kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare Nr. 138 të vitit 2016, dhe përkatësisht në datën 11 Gusht 2016. Megjithëse që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve Kushtetuese ka kaluar një periudhë përafërsisht prej 1 viti e gjysmë, institucioni i KLP-së nuk është krijuar ende.

Tabela e mëposhtme jep përditësimet e në lidhje me ngritjen e KLP-së. Tabela do të përditësohet periodikisht, deri në krijimin përfundimtar të KLP.

<sup>1</sup> Neni 179 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Neni 277 (1), Ligji Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”.

## II. Tabela – Ngritja e KLP-së

DATA	ANËTARË GJYQTARË	ANËTARË JURISTË (Avokat, Pedagog, Shoqëri Civile)
17 Janar 2017	Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr.18, datë 17.01.2017, ngriti komisionin administrativ për verifikimin e plotësimit të kushteve të kandidatëve prokurorë për KLP.	/
2017	Sipas njoftimit të Prokurorisë së Përgjithshme <sup>2</sup> Komisioni Administrativ identifikoi 19 kandidatët që plotësonin kriteret për anëtarë të KLP-së. Këta anëtarë duhet të votohen nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve.	/
22 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p><b>Mbledhja Nr. 1 e Nënkomisionit Parlamentar për përzgjedhjen anëtarëve të KLP-së:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Votimi:</b> asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash</li> <li>• <b>Shorti:</b> hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e zgjedhur me short.</li> <li>• <b>Miratim:</b> Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare</li> </ul>
25 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p><b>Votimi i Parë i Kuvendit:</b> me Vendimin Nr. 4/2018 datë 25.1.2018, Kuvendi i Shqipërisë vendosi rrëzimin e listës në bllok të anëtarëve të KLP-së që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 1 të Komisionit Parlamentar, sepse nuk u arrit shumica prej 2/3.</p>
29 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p><b>Mbledhja Nr. 2 e Nënkomisionit Parlamentar për përzgjedhjen anëtarëve të KLP-së:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Votimi:</b> asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash</li> <li>• <b>Shorti:</b> hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e</li> </ul>

<sup>2</sup>[http://www.pp.gov.al/web/Shpallen\\_kandidatet\\_zyrtare\\_per\\_Keshillin\\_e\\_Larte\\_te\\_Prokurorise\\_1040\\_1.php#.WoLeo66nHct](http://www.pp.gov.al/web/Shpallen_kandidatet_zyrtare_per_Keshillin_e_Larte_te_Prokurorise_1040_1.php#.WoLeo66nHct)

DATA	ANËTARË GJYQTARË	ANËTARË JURISTË (Avokat, Pedagog, Shoqëri Civile)
		zgjedhur me short. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Miratim:</b> Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare</li> </ul>
<b>1 Shkurt 2018</b>	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<b>Votimi i Dytë i Kuvendit:</b> Me Vendimin Nr. 12/2018 datë 01.02.2018, Kuvendi i Shqipërisë vendosi rrëzimin e listës në bllok të anëtarëve të KLP-së që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 2 të Komisionit Parlamentar, sepse nuk u arrit shumica prej 2/3.
<b>5 Shkurt 2018</b>	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<b>Mbledhja Nr. 3 e Nënkomisionit Parlamentar për përzgjedhjen anëtarëve të KLP-së:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Votimi:</b> asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash</li> <li>• <b>Shorti:</b> hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e zgjedhur me short.</li> <li>• <b>Miratim:</b> Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare</li> </ul>
<b>8 Shkurt 2018</b>	Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga rradhët e Prokurorisë <b>nuk është mbledhur</b> dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<b>Votimi i Tretë i Kuvendit: edhe në votimin e tretë të datës 8 Shkurt 2018 Kuvendi i Shqipërisë nuk e arriti shumicën prej 2/3. Si rrjedhojë e parashikimit të nenit 149 (8) të Kushtetutës së ndryshuar, lista e tretë që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 3 të Nënkomisionit Parlamentar u konsiderua automatikisht e miratuar. 5 Anëtarët e KLGj-së janë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Avokatia:</b> Nurihan Seiti dhe Tartar Bazaj</li> <li>• <b>Pedagogët:</b> Gent Ibrahimimi dhe Sandër Beci</li> <li>• <b>Shoqëria Civile:</b> Alfred Balla</li> </ul>